

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e ri të komunës së Mamushës
Kryetari Bütuç emëron nënkryetarin e parë dhe drejtorët e ekzekutivit lokal

10 janar 2014, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Transparenca online e Komunës së Prizrenit dhe Mamushës” ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të kryetarit të komunës së Mamushës, Arif Bütuç me drejtorët komunal që janë emëruar rishtas në këto detyra.

Kryetari i Komunës, Arif Bütuç pas dhënies së betimit ka ndërmarrë hapa për krijimin e ekipit të ri të ekzekutivit komunal. Gjatë kësaj jave ai ka emëruar nënkryetarin e parë dhe gjashtë drejtorët e qeverisë komunale të Mamushës.

Nënkryetar i parë i Komunës është emëruar Ilyas Bayraktar.

Ndërsa drejtorët e përzgjedhur nga kryetari Bütuç janë:

1. Cafer Morina, Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
2. Agim Morina, Drejtor i Shërbimeve Publike,
3. Rujdi Kryezi, Drejtor i Shëndetësisë,
4. Yalçin Mazrek, Drejtor i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Gjeodezisë e Kadastrës,
5. Reshat Mazrek, Drejtori i Administratës së Përgjithshme, dhe
6. Skender Shala, Drejtor i Ekonomisë dhe Financave.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklician 14 (kati V), 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës” prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.